

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 711, DATË 29.10.2014 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN E VARREZAVE NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektakti është miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimin nr. 711, datë 29.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë” (VKM nr. 711/2014) në funksion të rregullimit të mëtejshëm për ushtrimin e aktivitetit të agjencive funerale.

Nëpërmjet këtij projektvendimi synohen të bëhen shtesa dhe ndryshime me qëllim qartësimin e parashikimeve në VKM-në nr. 711/2014, si dhe pasja e një koherence ndërmjet situatës ligjore për ushtrimin e aktivitetit të agjencive funerale, zhvillimit të shoqërisë dhe këtij aktiviteti, si dhe traditave e zakoneve të reja që qytetarët po ndjekin për të nderuar, personat që humbin jetën.

Në vija të përgjithshme ky projektakt jep përkufizimin e “Shtëpive funerale” dhe funksionimin e tyre duke qenë se janë risi në shoqërinë tonë, si dhe bëhen ndryshime të rëndësishme sa i takon licencimit të agjencive funerale dhe organit që do t’i kontrollojë për mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të tyre.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT, NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTET TË TJERA POLITIKE

Ky projektakt nuk është parashikuar dhe nuk është pjesë përbërëse e programit analistik të akteve të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT, LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Relacion shpjegues për projektvendimin, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 711, datë 29.10.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”

Pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, në mënyrë të përsëritur janë depozituar ankesat nga qytetarët në lidhje me mënyrën e ushtrimit të aktivitetit nga agjencitë funerale private. Ankesat e qytetarëve lidhen kryesisht me vendosjen e Agjencive në ambiente pallatesh dhe mos respektimin e rregullave të parashikuara në VKM-në nr. 711/2014 për ushtrimin e aktivitetit. Bashkia Tiranë, së fundmi nëpërmjet shkresës nr. 11666 prot., datë 25.3.2022 ka informuar për problematikat e të gjithë qytetarëve dhe ka kërkuar bashkëpunimin për të vlerësuar iniciimin e disa ndryshimeve në legjislacionin në fuqi që rregullon këtë shërbim, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë agjencitë me qëllim ushtrimin e aktivitetit të tyre, si dhe strukturat që duhet t'i licencojnë/kontrollojnë agjencitë.

Në vlerësimin që i është bërë legjislacionit në fuqi konstatohet mangësia e përkufizimit dhe rregullimit të mëtejshëm të "Shtëpive funerale". Ky shërbim filloj të kërkohej nga qytetarët gjatë periudhës së pandemisë së COVID-19, ku përveç shërbimit për pritjet, aktualisht kërcohët edhe kryerja e ceremonisë mortore në ambiente të posaçme. Të ndodhur para një zakoni të ri të qytetarëve, ku evidentohet që legjislacioni në fuqi nuk ka parashikime për funksionimin e "Shtëpive funerale", shtesat e parashikuara në këtë projektakt, vendosin para kontureve ligjore ofrimin e shërbimit të "Shtëpive funerale".

Disa problematika të tjera të hasura gjatë zbatimit të parashikimeve të VKM-së nr. 711/2014 kanë të bëjnë me licencimin e Agjencive, kushtet dhe kriteret që ato duhet të plotësojnë, si dhe struktura që i kontrollon për mënyrën e ushtrimit të aktivitetit. Aktualisht, për të ushtruar aktivitetin e Agjencive funerale, subjektet duhet vetëm të registrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nuk ka parashikime shteruese lidhur me kriteret e licensimit, kapacitetet teknike, burimet njerëzore etj. Gjithashtu, duke qenë se Agjencitë kryesisht janë të vendosura në ambiente pallatesh dhe zona të banuara, konstatohet një vakum ligjor, sa i takon strukturës përgjegjëse për kontrollin e këtyre Agjencive, në rastet e ankesave të qytetarëve apo subjekteve të tjera.

Në këto kushte, me ndryshimet e parashikuara në këtë projektakt qartësohet mënyra e licencimit të Agjencive, duke parashikuar që licencimin e bëjnë njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe po këto të fundit parashikojnë në mënyrë shteruese kriteret dhe kushtet e licencimit konform VKM-së nr. 711/2014. Gjithashtu, duke qenë se njësitë e vetëqeverisjes vendore do të janë organ licencues, këto të fundit janë parashikuar që të janë dhe struktura përgjegjëse për kontrollin e tyre.

Këto shtesa dhe ndryshime vlerësohen si të nevojshme dhe efikase, duke ofruar kështu një kuadër ligjor, i cili do të ishte më i qartë për t'u zbatuar nga të gjitha palët, si dhe do të ndihmonte më tej në mirëfunksionimin e shërbimit të agjencive.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës, 2, të nenit 3/d, të ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004, “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektvendim nuk përafron akte me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përbëhet nga dy Kre dhe gjithsej nga 7 pika.

Në Kreun e I bëhen shtesat dhe ndryshimet në Rregulloren për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë, miratuar me VKM-në nr. 711/2014.

Në pikën 1 të Kreut I jepet përkufizimi i “Shtëpive funerale”, të cilat janë ambiente të padukshëm nga jashtë, i cili shërben si shtëpi pritje për kryerjen e ritualeve të lamtumirës dhe riteve të tjera në nderim të personave të vdekur.

Në pikën 2 të Kreut I, në shkronjë “a” është parashikuar që licencimi i Agjencive të shërbimit funeral të bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, Agjencitë mund të licencoohen edhe për ofrimin e shërbimit për shtëpi funerale. Në shkronjën “b” të kësaj pike është parashikuar që njësitë e vetëqeverisjes vendore të përcaktojnë kriteret dhe kushtet që Agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotësojnë për t'u licencuar.

Në pikën 3 të Kreut I, në shkronjë “a” është parashikuar që Agjencitë dhe shtëpitë funerale duhet të zhvillojnë aktivitetin, si: plotësimi i formaliteteve, shitja e artikujve të varrimit dhe çdo aktivitet tjeter që lidhet me funeralin, brenda ambienteve të miratuara dhe që janë jo të dukshëm nga jashtë. Ndërsa, në shkronjën “b” është përcaktuar që njësitë e vetëqeverisjes vendore të kontrollojnë agjencitë e shërbimit funeral dhe shtëpitë funerale për plotësimin dhe respektimin e kushteve dhe kritereve për ushtrimin e aktivitetit të tyre, të parashikuara në këtë vendim dhe në rregulla të tjera të vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në Kreun II, në pikën 1 parashikohet licencimi automatikisht i Agjencive të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Në Kreun II, në pikën 2 është përcaktuar një afat 6 mujor për plotësimin e kushteve dhe kritereve nga Agjencitë që janë aktualisht në treg, kur këto të fundit nuk plotësojnë kriteret dhe kushtet e licencimit dhe rregullat e tjera të vendosura nga njësítë e vetëqeverisjes vendore.

Në Kreun II, në pikën 3, përcaktohet që në rastet kur Agjencitë nuk plotësojnë kushtet për licencim brenda afatit 6-mujor ato nuk licencohen.

Në Kreun II, në pikën 4, përcaktohen strukturat përgjegjëse që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe njësítë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. MINISTRITË, PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi dhe relacioni shpjegues janë përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Projektvendimi është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme dhe Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOKE

Zbatimi i projektvendimit, nuk shoqërohet me kosto financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

Relacion shpjegues për projektvendimin, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 711, datë 29.10.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë"